



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2019:169221

Datë: 30.01.2026

Numri i dokumentit: 08398380

**PA1.nr.726/24**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Mehmet Ndrecaj - anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale kundër të akuzuarit Glauk Konjufca, për shkak të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 par.1, të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.464/17, datë 26.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur, konform të dispozitës së nenit 390 të KPP-së, më datë 27.02.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.464/17, datë 26.02.2024, përkitazi me veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 par.1 të KPRK-së, **anulohet** dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë për rigjykim dhe vendim.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.464/17, datë 26.02.2024, të akuzuarin Glauk Konjufca, për shkak të veprave penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 par.1 të KPRK-së, konform të dispozitës së nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPRK-së e ka liruar nga akuza, me arsyetim se nuk është provuar që i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Ndërsa për veprën penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 par.1, të KPRK-së, konform të nenit 362 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së e ka refuzuar akuzën. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. Palë të dëmtuar nuk ka pasur të propozuar në këtë çështje penale.

**Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :**

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për pjesën liruese dhe atë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta shpall fajtor për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 par.1 të KPRK-së dhe ti shqiptoi dënim në proporcion me peshën e veprës penale ose aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen të ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

Përgjigje në ankesën e prokurorit ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit Glauk Konjufca av. Arbnora Zeqiri, me propozim që ankesa e prokurorit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën PPA/II.nr.728/24, datë 15.05.2024 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e prokurorit, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarin ta shpall fajtor për veprat penale, ose të njëjtën ta anuloj dhe çështjen të ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

Gjykata e Apelit cakto dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së e për të cilën seancë i ftoi në mënyrë të rregullt Prokurorin e Apelit, të akuzuarin Glauk Konjufca, mbrojtësen e tij av. Arbnora Zeqiri. Në seancë prezantoi vetëm mbrojtësja e të akuzuarit av. Arbnora Zeqiri, ndërsa Prokurori i Apelit si dhe palët të tjera edhe pse të ftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë. Gjyqtari referues e referoj çështjen penale. Mbrojtësja e të akuzuarit av. Arbnora Zeqiri, deklaroi se e mbështet në tërësi ankesën e ushtruar me shkrim, me tej të njëjtën e elaboroj, me propozim që ankesa e prokurorit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa vendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, pasi që gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim të drejtë. Meqenëse provat që ka ofruar prokurori nuk paraqesin fakte që provojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është liruar nga akuza me të drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë. I akuzuari është deklaruar i pa fajshëm, gjatë gjithë procedurës. Gjithashtu mbetem në tërësi pranë përgjegjës në ankesën e prokurorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

**-Me aprovimin e ankesës së Prokurorit e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i ankimuar anulohet si në dispozitiv të këtij aktvendimi.**

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar që, gjykata sa i përket pikës I të dispozitivit të aktgjykimit ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike kur ka konstatuar se personi nuk është penalisht përgjegjës, kur midis veprimit ose mos veprimit të tij dhe si pasojës mungon lidhja shkakore, sepse në rastin konkret ekzistonte lidhja shkakore midis veprimit dhe pasojës. Sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit gjykata ka konstatuar me të drejtë se ka kaluar afati i parashkrimit, sepse gjatë kohës sa lënda ishte në

gjykatë kishte kaluar ky afat ligjor. Gjykata ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike sa i përket pikës I të aktgjykimit, për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 par.1 të KPRK-së. Gjykata ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike kur ka konstatuar se është kontestues fakti se kush e ka hedhur mjetin që dyshohet se ishte gaz lotsjellës, ashtu që në mungesë të raportit për konfiskimin e sendit, pasi në shkresat e lëndës mungon vërtetimi për sekuestrimin të sendit me të cilin prokuroria pretendon se është kryer vepra penale, përkundër që gjykata në procedurën e administrimit të provave e ka pyetur prokurorin e shtetit nëse është sekuestruar sendi që është mjet me të cilin pretendohet të jetë kryer vepra penale, përmes të cilit do të vërtetohej lidhshmëria e të akuzuarit me mjetin e pretenduar të kryerjes së veprës penale. Ka bërë vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike kur ka konstatuar se prokuroria nuk ka arritur në asnjë fazë të shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale të sigurojë dhe të prezantoj para gjykatës këtë provë kruciale për të vërtetuar të gjitha pretendimet e ngritura në këtë çështje penale, mbi të gjitha lidhshmërinë kauzale dhe përdorimin e mjetit nga i akuzuari. Prokuroria konsideron se ky është tërësisht konstatim i gabuar, sepse prokurori i shtetit në procedurën e administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor i ka paraqitur gjykatës prova se është sekuestruar bombola e gazit lotsjellës. Provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe që e vërtetojnë faktin se është sekuestruar bombola e gazit lotsjellës janë: I . Raporti i kryerjes së vendit të ngjarjes, Lokacioni i incidentit Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla e mbledhjeve nr. 301, Data/koha e incidentit 10.08.2016, nga i cili është vërtetuar se policia ka dalur në vendin e ngjarjes dhe ka këqyrur vendin e ngjarjes dhe ka përpiluar raport, të cilit ia ka bashkangjitur edhe fotoalbumin dhe listën e dëshmimeve, nga i cili raport i këqyrjes së vendit të ngjarjes vërtetohet se në mesin e sallës, respektivisht afër vendit, ku ka qenë i ulur i pandehuri Glauk Konjufca sipas emrit, që e kishte të vendosur përpara në tavolinë është gjetur një bombolë e gazit lotsjellës. Lista e dëshmimeve, Data-koha e incidentit 10.08.2016, nga e cila është vërtetuar se si dëshmi është sekuestruar dëshmia e evidentuar bombolë e gazit lotsjellës e zbrazët, Vendi i gjetjes: në dysheme në mesin e tavolinave në sallën 301. Fotoalbumi, nga i cili është vërtetuar se bombola e gazit lotsjellës e zbrazët është gjetur në sallën C 301 dhe është fotografuar nga afërsia. Gjykata ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike kur ka konstatuar se prokuroria thjesht specifikon nga dëshmitarët se është dëshmuar hedhja e gazit lotsjellës, fakt që është shqyrtuar në fazën e ngritjes së akuzës dhe në fazat e mëvonshme procedurale. Ky është një konstatim i gabuar se përveç provave materiale, pra edhe provat personale — dëshmitë e dëshmitarëve dhe mbrojtja e vet të pandehurit në shqyrtim gjyqësor e kanë vërtetuar faktin se i pandehuri e ka hedhur gazin lotsjellës. Me dëshmitë e dëshmitarëve A. G., I. B., S. P., S. P. dhe V. B. të dëgjuar në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se me datën 10.08.2016 gjatë mbajtjes së mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës në sallën C-301 është hedhur gaz lotsjellës, kurse dëshmitari P. L. ka deklaruar se nuk i kujtohej se ishte hedhur gaz lotsjellës. Po ashtu edhe vet i pandehuri Glauk Konjufca në fjalën hyrëse ka deklaruar, po citoj deklarin e të pandehurit nga Procesverbali i shqyrtimi fillestar i dt. 19.04.2022: "Veprimi ka qenë plotësisht politik, e kam ndier veten të obliguar që ta bëj, kjo ka ardhur nga betimi që e kam dhënë si deputet i Kosovës, ku kam deklaruar që me çdo kush e me çdo mjet do ta mbroj sovranitetin dhe integritetin e Kosovës", kurse në seancën e shqyrtimit gjyqësor i pandehuri Glauk Konjufca ka deklaruar, po e citoj Procesverbalin për vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor të dt. 21.02.2024: "unë i përmbahem deklarimeve të mëhershme dhe sipas udhëzimeve të gjykatës do t'i përmbahem udhëzimit dhe atë çka më lejon ligji që të mbrohem në heshtje". Në deklaratën e mëhershme, të dhënë në prokurori me datën 08.09.2016 i pandehuri Glauk Konjufca ndër të tjera ka deklaruar se atë ditë e ka përdorur gazin lotsjellës, por ka deklaruar se gazin lotsjellës nuk e konsideron që është armë dhe atë duke u bazuar në Ligjin për armët, ku ceket se gazi lotsjellës është municion dhe asgjë më shumë. Gjykata ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike kur ka konstatuar se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk munda ta provojë këtë çështje penale, me prova të tjera për të verifikuar nëse ishte e vërtetë një gjë e tillë në atë situatë faktike të përshkruar nga

prokuroria dhe se për gjykatën argumentimi i prokurorisë në këtë çështje mbeti dhe u pasqyrua vetëm si dyshim për ekzistencën e çështjes penale dhe përgjegjësisë penale. Për prokurorinë ky është konstatim i gabuar, sepse përveç dëshmive të dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor dhe mbrojtjes së të pandehurit në shqyrtim gjyqësor edhe me provat materiale është vërtetuar se i pandehuri Glauk Konjufca e ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375, par. I të KPRK-së, pasi nga këto prova është vërtetuar si vijon. Raporti i kryerjes së vendit të ngjarjes, Lokacioni i incidentit Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla e mbledhjeve nr. 301, Data/koha e incidentit 10.08.2016 është vërtetuar se policia ka dalur në vendin e ngjarjes dhe ka këqyruar vendin e ngjarjes dhe ka përpiluar raport, të cilit, ia ka bashkangjitur edhe fotoalbumin dhe listën e dëshmive, nga i cili raport i këqyrjes së vendit të ngjarjes vërtetohet se në mesin e sallës, respektivisht afër vendit, ku ka qenë i ulur i pandehuri Glauk Konjufca sipas emrit, që e kishte të vendosur përpara në tavolinë është gjetur një bombolë e gazit lotsjellës. Nga lista e dëshmive, Data/koha e incidentit 10.08.2016 është vërtetuar se si dëshmi është sekuestruar dëshmia e evidentuar E#1 bombolë e gazit lotsjellës e zbrazët, vendi i gjetjes: në dyshe në mesin e tavolinave në sallën 301. Nga Foto albumi është vërtetuar se bombola e gazit lotsjellës e zbrazët është gjetur në sallën C 301 dhe është fotografuar nga afërsia. Nga Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit e mbajtur me 10 gusht 2016 është vërtetuar se pjesëmarrës në këtë mbledhje ka qenë tani i pandehuri Glauk Konjufca dhe se në faqen e dytë të këtij procesverbali konstatohet: "Gjatë zhvillimi të diskutimeve, kryetari i GP të LVV-së, z. Glauk Konjufca hodhi gaz lotsjellës në sallën C-301. Për shkak të pamundësisë për të vazhduar, kryetari e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit". Pra nga ky procesverbal është vërtetuar se gjatë zhvillimit të diskutimeve në sallën C-301 tani i pandehuri Glauk Konjufca ka hedhur gaz lotsjellës dhe për shkak të pamundësisë për të vazhduar është ndërprerë mbledhja e kryesisë Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjykata ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike kur ka konstatuar se nuk ia fal besimin procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur me 10 gusht 2016, përmes të cilit është vërtetuar se pjesëmarrës në këtë mbledhje ka qenë tani i pandehuri Glauk Konjufca dhe se në faqen e dytë të këtij procesverbali konstatohet: "Gjatë zhvillimi të diskutimeve, kryetari i GP të LVV-së, z. Glauk Konjufca hodhi gaz lotsjellës në sallën C-301. Për shkak të pamundësisë për të vazhduar, kryetari e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit". Pra nga ky procesverbal është vërtetuar se gjatë zhvillimit të diskutimeve në sallën C-301 tani i pandehuri Glauk Konjufca ka hedhur gaz lotsjellës dhe për shkak të pamundësisë për të vazhduar është ndërprerë mbledhja e Kryesisë së Kuvendit të Republikës si Kosovës. Gjykata ka theksuar se nuk ia fal besimin, pasi që konstatimet e tij nuk ishin të konfirmuara nga autoriteti, që e ka lëshuar procesverbalin edhe pse i njëjti ishte nxjerrë nga web-faqja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, por gjykata sipas nenit 355 të KPP-së nuk ka çmuar se duhet të merret një konfirmim i tillë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, por sikur të kishte çmuar, një konfirmim i tillë do të mund të merrej nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pasi ky procesverbal pas miratimit është publikuar dhe pastaj është ruajtur në arkivin e Kuvendit të Republikës së Kosovës sikurse parashihet me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjykata ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike kur ka vlerësuar deklarin e të pandehurit në shqyrtim gjyqësor si të trajtë të gabuar konkluduese dhe ka cituar gabim "se do të qëndrojë i përmbajtur deklaratave të mëparshme dhe në përputhje me udhëzimet ligjore të gjykatës do të mbrohet në heshtje", por gjendja faktike është krejt ndryshe, sepse i pandehuri në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar ndryshe, prandaj po citoj deklarin e të pandehurit Glauk Konjufca nga procesverbali për vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor i dt. 21.02.2024, ku i njëjti ka deklaruar: "unë i përmbahem deklarimeve të mëhershme dhe sipas udhëzimeve të gjykatës do t'i përmbahem udhëzimit dhe atë çka më lejon ligji që të mbrohem në heshtje". Kurse në deklaratën e mëhershme, të dhënë në prokurori me datën 08.09.2016 i pandehuri Glauk Konjufca ndër të tjera ka deklaruar se atë ditë e ka përdorur gazin lotsjellës, por ka deklaruar se gazin lotsjellës nuk e konsideron që është armë dhe atë duke u bazuar në Ligjin për armët, ku

ceket se gazi lotsjellës është municion dhe asgjë më shume. Prokurori i shtetit i ka cekur këto deklarime të pandehurit edhe në fjalën përfundimtare dhe po ashtu ka theksuar se një pretendim i tillë i të pandehurit nuk është në pajtim me Kodin Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 04/L-082), pasi neni 120, par. 38 i këtij kodi përcakton se arme janë municioni, pjesët dhe përbërësit e armëve, si dhe armët nukleare, biologjike dhe kimike. Po ashtu theksojmë se lidhur me veprën e njëjtë penale, ku edhe provat materiale kanë qenë po thuajse të njëjta, e njëjta gjykatë, përkatësisht Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm ka marrë aktgjykim dënues P.nr. 1509/18, të dt.11.11.2021, i cili aktgjykim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës. Me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta shpall fajtor për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 par.1 të KPRK-së dhe ti shqiptoi dënim në proporcion me peshën e veprës penale ose aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen të ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa e Prokurorit është e bazuar e duke e shqyrtuar edhe sipas detyrës zyrtare vlerëson se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë edhe në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e që lidhen edhe me vërtetim të gabuar he jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal, shkelje këto të karakterit absolut që detyrimisht kushtëzojnë anulimin e këtij aktgjykimi. Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.10 dhe lidhur me nenin 363 të KPP-së e që lidhen edhe me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike nga neni 386 par.3, të KPPK-së, sepse sipas shkresave të lëndës, rezulton se, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë provat e administruara dhe atë dëshmitë e dëshmitarëve A.G., I.B., V. B., S. H dhe S. P., provat materiale si raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, lokacioni i incidentit Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla e mbledhjeve C.nr. 301, data/koha e incidentit, lista e dëshmive( dëshmia E-1, bombolë e gazit lotsjellës e zbrazët, si dhe vendi i gjetjes ne dysheme në mesin e tavolinës ne sallën 301), Fotoalbumi dhe lista e dëshmive, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, lokacioni i incidentit (Ndërtesa e Kuvendit të Republikës se Kosovës- salla e mbledhjeve nr.30), data dhe koha e incidentit 10.08.2016, lista e dëshmive (dëshmia E-1, bombolë e gazit lotsjellës e zbrazët, si dhe vendi i gjetjes në dysheme në mesin e tavolinës në sallën 301), Foto-albumi, data e incidentit 10.08.2016, data e fotografive 10.08.2016 nga drejtorja e Teknikes Kriminalistike të Policisë së Kosovës, Procesverbal i mbledhjes së kryesisë së kuvendit të mbajtur më 10.08.2016, si dhe pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar nuk ka paraqitur drejtë se cilave prova ia fal besimin apo të cilave nuk ia fal besimin e po ashtu se cilat prova të administruara i konsideron të vërtetuara e cilat të pavërtetuara, nuk ka bërë në mënyrë të drejtë krahasimin e këtyre provave njëra me tjetrën dhe në lidhmëri njëra me tjetrën dhe se arsyetimi i dhënë në këtë drejtim nga gjykata e shkallës së parë është jo i drejtë dhe jo i plot. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar numëron provat e administruara të lartcekura, por nuk i argumenton bindshëm se pse e ka liruar të akuzuarin nga vepra penale e cila i vihet në barrë me anë të aktit akuzues. Po sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate, përfundimin e gjykatës së shkallës së parë ” se Prokuroria, përmes dëshmitarëve të propozuar, nuk e ka provuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, duke mos arritur të vërtetojë lidhjen kauzale dhe veprimet e pretenduara inkriminuese të ndërmarra nga i akuzuari. Mungesa e vërtetimit për sekuestrimin

po ashtu, nuk vërteton vlerën provuese dhe arsyetimin dhe pretendimet e prokurorisë se provat e larta cekura janë sekuestruar në mënyrën dhe aspektin provues që do të provonin se i akuzuari ka lidhje kauzale dhe përgjegjësi penale për gjendjen faktike, siç është në akuzë. Mungesa e vërtetimit për sekuestrim po ashtu konkludon edhe në pamundësinë e provave të administruara dhe shkresave të lëndës për të argumentuar se çfarë është sekuestruar në lidhje me përgjegjësinë penale dhe veprimet inkriminuese të akuzuarit.” Një përfundim i tillë i gjykatës së shkallës së parë sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate është jo i drejt dhe jo i plot ngase në këtë çështje penale përpos dëshmive të dëshmitarëve kemi edhe provat tjera materiale e po ashtu kemi edhe vet pohimin e të akuzuarit në deklarin e tij në prokurori ku ndër të tjera ka deklaruar “ se atë ditë e ka përdorur gazin lotsjellës, por ka deklaruar se gazin lotsjellës nuk e konsideron që është armë dhe atë duke u bazuar në Ligjin për armët, ku ceket se gazi lotsjellës është municion dhe asgjë më shume”, po ashtu kemi edhe procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur me 10 gusht 2016, ku ndër tjera konstatohet se "Gjatë zhvillimi të diskutimeve, kryetari i GP të LVV-së, z. Glauk Konjufca hodhi gaz lotsjellës në sallën C-301. Për shkak të pamundësisë për të vazhduar, kryetari e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit" edhe pse gjykata e shkallës së parë e administroi si provë Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit mirëpo të njëjtës provë gjykata e shkallës së parë “ nuk i kushtoi besimin dhe arsyetimi se pas analizimit të përmbajtjes së kësaj prove gjykata vlerësoi se konstatimet e përmbajtjes së procesverbalit fillimisht nuk ishin të konfirmuara nga autoriteti që lëshoi procesverbalin, në këtë rast, Kuvendi i Republikës së Kosovës”. Një arsyetim i tillë i gjykatës së shkallës së parë rreth kësaj është jo i drejt, jo i plotë dhe konfuzë , ngase këtë provë e ka propozua Prokurori për tu administrua nga ana e gjykatës, të njëjtën provë Prokuroria e ka sigurua përmes web-faqës zyrtare të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe se gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pas mundësin që të kërkoj nga ana e prokurorit të provoi vërtetësinë e të njëjtit apo edhe vet gjykata zyrtarisht ta bëj këtë, mirëpo këtë nuk e ka bërë. Po ashtu përfundimin e gjykatës së shkallës së në mesë tjerash me rastin e lirimit të akuzuarin nga akuza, vendimin e saj e bazon edhe në dispozitën 257 par.2 të KPPRK-së që parashihet, “Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklarinimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit të shtetit” si dhe në nenin 20 të KPRK-së, ku parashihet që: “Personi nuk është penalisht përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojës mungon lidhja shkakore”. Një përfundim i tillë i gjykatës së shkallës së parë sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate është jo i drejt, jo i sakët dhe jo i plot ngase në këtë çështje penale përpos deklarinimit të akuzuarit në prokurori, kemi edhe deklaratat e dëshmitarëve, provat tjera materiale e sidomos procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur me 10 gusht 2016, ku ndër tjera konstatohet se "Gjatë zhvillimi të diskutimeve, kryetari i GP të LVV-së, z. Glauk Konjufca hodhi gaz lotsjellës në sallën C-301. Për shkak të pamundësisë për të vazhduar, kryetari e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit”. Nga të gjitha të lartcekurat, gjykata e shkallës së parë ka dështuar që ta vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe posaçërisht të plotë gjendjen faktike e më vërtetimin jo të drejtë dhe jo të plotë të gjendjes faktike në rastin konkret është shkelur edhe ligji penal në favor të të akuzuarit. Të gjitha këto shkelje sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate janë të karakterit absolut, që detyrimisht kushtëzojnë anulimin e këtij aktgjykimi.

Në lëndën në rivendosje gjykata e shkallës së parë edhe njëherë të i administroi të gjitha provat që janë të propozuara nga prokurori në aktakuzë dhe ato të cilat i propozon mbrojtësi i të akuzuarit dhe i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor. Provat të i administroj një nga një dhe në lidhmëri njëra me tjetrën, të i vlerësoj të njëjtat në mënyrë meritore dhe pas kësaj, të nxjerrë vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga të lartcekurat, Gjykata e Apelit, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashtë të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e lartcekura ti eliminoj të gjitha shkeljet e cekura dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerr konkluzione të drejta të ligjshme e të bazuara me provat e administruara e mandej të marrë vendim përkatës.

Për pjesën refuzuese përkitazi me veprën penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 par.1 të KPRK-së, pasi që Prokurori i Prokurorisë Themelore nuk e ankimon në këtë drejtim, aktgjykimi i ankimuar ngel i pandryshuar.

Nga sa u tha më lartë e sipas dispozitës së nenit 402 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
PA1.nr.726/24, datë 27.02.2025

**Zyrtarja ligjore**  
Rrezarta Bala

**Anëtarët e kolegjit:**  
Ferit Osmani

**Kryetari i kolegjit**  
Skender Çoçaj

Mehmet Ndrecaj